



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

UDHËZUES

Për aplikim për punësim në strukturat e shërbimit MZSH-së

Misioni i shërbimit të MZSH-së

Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Ndërhyrjet Operacionale

Stacionet Zjarrfikëse ndërhyjnë në rastet e zjarreve ose aksidenteve. Në rast zjarri ose aksidenti efektivat dhe automjetet zjarrfikëse ndërhyjnë duke dhënë ndihmën e drejtpërdrejtë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës.

Pagat dhe përfitimet

1. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në këtë ligj, në të cilin përfshihen:

- a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune;
- b) ndihma financiare në rastet e fatkeqësive në familje, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- c) ndihma e menjëhershme financiare, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit.
- d) Punonjësi i shërbimit të MZSH-së përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së, që ndërpret marrëdhëniet e punës me shërbimin, përfiton:

- a) pagesë kalimtare;
- b) pension të parakohshëm suplementar;
- c) pension suplementar pleqërie.

Detyrat dhe përgjegjësit

Shërbimi i MZSH-së ka këto detyra kryesore:

- a) ndërhyjnë me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjësë së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme;
- b) harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri;
- c) organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve, të pronës, nga rreziku i zjarrit;
- d) organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme;
- e) organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri;
- f) ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike;
- g) bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera;
- h) përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;
- i) kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese;
- j) njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit.

Kushtet e punës

Punonjësit e MZSH-së, në përputhje me detyrat funksionale janë të pajisur me uniformat dhe mjetet mbrojtëse për të përmbushur detyrat operacionale, si dhe mjediset përkatëse për mjetet zjarrfikëse dhe zyrat e punës.

Mundësitë e ecjes në karrierë

Punonjësit e shërbimit të MZSH-së kanë mundësi ecje në karriere në përputhje me nivelet e gradave si më poshtë:

Niveli bazë:

- a) “Asistent zjarrfikës”;
- b) “Zjarrfikës”;
- c) “Kryezjarrfikës”.

Niveli mesëm:

- a) “Inspektor zjarrfikës”;
- b) “Kryeinspektor zjarrfikës”;
- c) “Komisar zjarrfikës”.

Niveli lartë:

- a) “Drejtues zjarrfikës”;
- b) “Drejtues i parë zjarrfikës”.

Niveli madhor:

“Drejtues i lartë zjarrfikës”.

Kriteret e domosdoshme për përzgjedhjen e aplikantit

Kriteret e domosdoshme të pranimit për nivelin bazë të këtij shërbimi janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- d) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- e) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- f) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;

si dhe të tjera të përcaktuar në ligjin organik.

Procedura e aplikimit

Kandidatët duhet të paraqesin pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Mat dokumentat vijues:

1. Formular aplikimi;
2. Fotokopje e kartës së identitetit;

3. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
4. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
5. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;
6. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
7. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “C”;
8. Certifikatë e gjendjes gjyqësore;
9. Certifikatë familjare;
10. Vërtetim nga gjykata;
11. Vërtetim nga prokuroria;
12. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kyer detyra me rrezik të shtuar”;
13. Fotokopje e librezës së punës e njësuar me origjinalin;
14. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
15. Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) cope.